



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PEJË**  
OSNOVNI SUD PEĆ – BASIC COURT PEJA

---

**P nr.154/17**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA THEMELORE NË PEJË D.P. , gjyqtari Sejdi Blakaj me sekretaren juridike Gjyljeta Çorkadiu , në lëndën penale kundër të pandehurit G. P sipas aktakuzës së PTH-së D.P. në Pejë PP/II. nr.47/17 të dt.10.2.2017, për shkak të veprës penale: të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar , publik dhe me gojë, të mbajtur në praninë e të pandehurit G. P dhe të prokurorit të shtetit Sanije Gashi Seferi me dt.08.2.2018 ka marrë dhe botërisht ka shpallë këtë :

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri G. P i lindur me dt.29.5.1977 në Pejë rruga P. e F pa nr, ku edhe tani jeton, i biri M dhe nënës M e gjinisë D, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës , kinse i pa dënuar më parë , gjendet në liri.**

**ËSHTË FAJTOR**

Për arsye se:

Me dt. 24.3.2016 m, rreth orës 16:00 në rrugën Ploja e Fierzës, në Pejë duke përdorë forcën , me dashje e ka goditur me grusht në fytyrë afër syrit të majtë, të dëmtuarin – e mitur V. C nga Peja , në atë mënyrë që përderisa i dëmtuari ishte duke i ndarë së rrahuri në mes tyre , djalin e dajës së tij Jetmirin 7 vjeçar dhe djalin e të pandehurit L. P , me ç ‘rast të dy këta i kishte kapur për veshi , i pandehuri i ofrohet dhe i drejtohet me fjalë “pse mi ka rrahur fëmijët” ku dhe menjëherë e grushton .

-me çka ka kryer veprë penale : të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata të pandehurit konform nenit 41, 42, 49, 50,51,52, dhe nenit 187 par 1 të KPRK-së. I SHQIPTON.

**DËNIM TË KUSHTËZUAR**

Në atë mënyrë që ia përcakton dënimin me burg në kohëzgjatje prej 6 muaj , e të cilin dënim i pandehuri fare nuk do ta vuaj nëse në afat prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale . I pandehuri për shkak të gjendjes së varfër ekonomike lirohet nga pagimi i paushallit gjyqësor

I dëmtuari për realizimin eventual të kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

Shpenzime procedurale nuk ka pasur .

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë me dt.10.2.2017 kundër të pandehurit G. P ka ngritë aktakuzë PP/II. nr.47/17 për vepër penale: të sulmit nga neni 187 par 1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë të pandehurin ta shpallë fajtorë , ta dënoj sipas ligjit dhe ta obligoj në pagimin e shpenzimeve procedurale .

Në shqyrtimin fillestarë i pandehuri – pasi që paraprakisht i është lexuar aktakuza , është njoftuar me të drejtat dhe detyrimet procedurale dhe pasojat e pranimit përkatësisht të mos pranimit të fajësisë- e ka pranuar fajësinë dhe ka manifestuar keqardhje për atë që i ka ndodhur. Këtë pranim fajësie gjyqtari – pasi që paraprakisht e ka marrë pëlqimin e prokurorit të shtetit, i bindur se pranim fajësinë i pandehuri e ka bërë ashtu siç e parasheh ligji – vullnetarisht dhe pa u ndikuar nga askush dhe në asnjë mënyrë -e ka pranuar .

Meqenëse i pandehuri e pranoj fajësinë gjyqtari kaloj në marrjen e vendimit lidhur me llojin dhe lartësinë e masës ndëshkuese , me ç rast i pati parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese. Rrethanë rënduese në rastin konkret gjyqtari nuk ka gjetur , kurse nga ato lehtësuese ka çmuar : pranimin e sinqertë të fajësisë , pendimin e thellë për këtë gjë, qëndrimin korrekt në gjykatë, pa dënueshmërinë e mëparshme, fakti se i pandehuri është i gjendjes së varfër ekonomike dhe mbajtës i vetëm i familjes prej 13 anëtarësh ku i njëjti realizon ndihma sociale faktin se me të dëmtuarin janë pajtuar dhe tani kanë raporte shumë të mira , dhe kësaj gjyqtari mendon se edhe me një vendim si në dispozitivin e aktgjykimit ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me neni 41 të KPK-së .

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 453 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontestin e rregullt civil është marrë konform nenit 463 të KPPRK-së .

Nga sa u tha më lartë konform nenit 365 të KPPRK-së u vendos si më lartë.

Nga Gjykata Themelore në Pejë D.P. datë.08.2.2018.

Sekretarja juridike  
Gjyljeta Çorkadiu

Gjyqtari  
Sejdi Blakaj

### **KËSHILLA JURIDIKE**

Kundër këtij aktgjykimi lejohet  
Ankesa në afat prej 15 ditësh nga  
Dita e marrjes , Gjykatës të Apelit në Prishtinë  
E përmes kësaj Gjykate .